REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LUSHNJE

Nr. 4063/1 Prot. **Lushnje më 13/05/2024**

PROJEKT-VENDIM

Nr.50, datë 13/05/2024

"PËR MIRATIMIN E AKTIT TË THEMELIMIT DHE STATUTIT TË SHOQËRISË SË TRAJTIMIT TË MBETJEVE URBANE TË QARKUT FIER" SH.A"

Këshillit të Bashkisë Lushnje, sot më datë____/___/2024, i paraqitet për shqyrtim, materiali nga ekzekutivi I Bashkisë Lushnje për miratimin e Aktit të themelimit dhe Statutit të Shoqërisë së Trajtimit të Mbetjeve Urbane të Qarkut Fier" sh.a, si një shoqëri tregtare e cila do të ketë objektin e veprimtarisë së saj përmbushjen e funksioneve vendore dhe shërbimit publik për mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake, grumbullimin, rehabilitimin dhe përpunimin e mbetjeve të ndryshme etj, në territorin administrativ të të gjitha Bashkive të Qarkut Fier.

Në zbatim të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit" i ndryshuar, në mbështetje të Marrëveshjes për krijimin e subjektit të përbashkët të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier", lidhur midis Bashkisë Fier,(nr. 9851 Prot, datë 11.11.2022), Bashkisë Lushnje (nr.10108 Prot., datë 14.11.2022), Bashkisë Divjakë (nr.5947 prot., datë 11.11.2022), Bashkisë Patos (nr.2670/1Prot.,datë 11.11.2022), Bashkisë Roskovec(nr.10096 Prot., datë 14.11.2022), Bashkisë Mallakastër (nr. 5618 Prot., datë 14.11.2022) si dhe Autorizimeve të dhëna me Vendimin nr. 81, datë 27.09.2022 të Këshillit të Bashkisë Fier, Vendimin Nr. 77, datë 13.10.2022 të Këshillit të Bashkisë Patos, Vendimin nr. 52, datë 28.09.2022 të Këshillit të Bashkisë Mallakastër, Vendimin nr. 69, datë 30.09.2022 të Këshillit të Bashkisë Roskovec, Vendimin nr. 92, datë 25.10.2022 të Këshillit të Bashkisë Lushnje, Vendimin nr. 49, datë 26.10.2022 të Këshillit të Bashkisë Divjakë,

bazuar në ligjin nr.139/2015" Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 54, gërma"d",Kryetari i Bashkisë,

Propozon:

1.Miratimin e Aktit të themelimit dhe Statutit të Shoqërisë së Trajtimit të Mbetjeve Urbane të Qarkut Fier" sh.a.

2.Ngarkohet Kryetari i Bashkisë Lushnje për ndjekjen e procedurave të mëtejshme administrative-ligjore për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit.

Për Drejtorinë Juridike

Bedri Hida

KRYETARI I BASHKISË

ERISELDA SEFA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA LUSHNJE